

Urdhër

Nr.223, datë 25.6.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “MBI PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE KËRKESAVE PËR CERTIFIKIMIN VETERINAR TË DISA LLOJE KAFSHËSH DHE MISHIT TË FRESKËT TË TYRE, TË CILAT HYJNË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NGA SHTETE TË CAKTUARA, SI DHE NGA TERRITORE TË TJERA NË ADMINISTRIM TË KËTYRE SHTETEVE”, TË MIRATUAR ME URDHRIN NR.328, DATË 22.11.2011

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 55 të ligjit nr.10 465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 18 të ligjit nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”,

Urdhëroj:

1. Në rregulloren “Mbi përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për certifikimin veterinar të disa lloje kafshësh dhe mishit të freskët të tyre, të cilat hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga shtete të caktuara, si dhe nga territore të tjera në administrim të këtyre shteteve”, miratuar me urdhër nr.328, datë 22.11.2011, modelet e certifikatave veterinare, të parashikuara në pjesën 2 të aneksit 2, shfuqizohen me qëllim përmirësimin dhe përshtatjen e tyre në përputhje me nevojat e tregut.
2. Certifikatat veterinare të përdorura përpara hyrjes në fuqi të urdhrit nr.328, datë 22.11.2011 “Për miratimin e rregullores mbi përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për certifikimin veterinar të disa lloje kafshësh dhe mishit të freskët të tyre, të cilat hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga shtete të caktuara, si dhe nga territore të tjera në administrim të këtyre shteteve” do të vazhdojnë të lejohen për shoqërimin e ngarkesave përkatëse që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
3. Drejtoria e Shërbimit Veterinar të ndjekë procedurat për njoftimin e këtij urdhri pranë autoriteteve homologe të vendeve anëtare të OIE-së, si dhe pranë OBT-së.
4. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Veterinar, Drejtoria e Sigurisë Ushqimore, si dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij urdhri.
5. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ministri i Bujqësisë, Ushqimit

dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

Genc Ruli